



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.41, datë 28.09.2007

**“PËR REVOKIMIN E PJESSHËM TË V.K.B. NR. 6, DATË 21.03.2005 “PËR RIORGANIZIMIN E TEATRIT TË CIRKUT, TEATRIT TË ESTRADËS, QENDRËS REKREATIVE “TIRANA” NË QENDRËN KULTURORE “TIRANA”, NIVELIN E PAGAVE TË PUNONJËSVE DHE KALIMIN KAPITAL TË PJESSHËM TË OBJEKTIT TË QENDRËS REKREATIVE “TIRANA”, PRANË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME NR. 1 TË PUNËTORËVE TË QYTETIT”**

Bazuar në Ligjin Nr.8652, dt.31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 10, pika 3/II/a, neni 32, pika ç, V.K.M. Nr.378, dt.12.08.1999 "Për kalimin e të drejtës së përfaqësuesit të pronarit për disa objekte pronë publike, organeve të qeverisjes vendore", V.K.M. Nr.153, dt.03.04.1993 "Për kalimin e objekteve e të mjeteve kryesore të ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore", pika 2, gërma "dh", Ligjin Nr.9228, dt.29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I**

1. Revokimin e pjesëshëm të pikës 1, të V.K.B. Nr. 6, dt.21.03.2005 "Për riorganizimin e Teatrit të Cirkut, Teatrit të Estradës, Qendrës Rekreative të Kulturës, në Qendrën Kulturore "Tirana" dhe nivelin e pagave të punonjësve".
2. Riaktivizimin e Qendrës Rekreative të Kulturës, si ndërmarrje me vetfinansim.
3. Në mbështetje të bilancit të Qendrës Rekreative të Kulturës më datë 31.12.2006, kalimin kapital me vlerë kontabile 1.675.500 lekë dhe amortizim 1.111.867 lekë dhe sipërfaqe ndërtimore 3113.95 m<sup>2</sup> si dhe sipërfaqe funksionale 5062.88 m<sup>2</sup>, të ndodhur në Rrugën "5 Maj", pranë Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 1 të Punëtorëve të Qytetit.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Qendra Rekreative e Kulturës, Qendra Kulturore "Tirana", Drejtoria e Kulturës, Rinisë & Sporteve dhe Drejtoria e Përgjithshme Nr. 1 e Punëtorëve të Qytetit, Drejtoria e Administrimit të Aseteve, Drejtoria e Buxhetit & Administrimit Financiar.
5. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SOKOL DERVISHAJ**

**K R Y E T A R**